3. Autoriteti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

-
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia e pritshme (m ²)	çmimi për njësi (m ²)	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Sipërfaqe Dysheme +Korridore+Shkallë	515,840 m ²			
2.	Sipërfaqe Tualete	44,640 m ²			
3.	Sipërfaqe Ambient i jashtëm	45,136 m ²			
4	Sipërfaqe Dritare+Vetrata	24,000 m ²			
				Çmimi total	_____
	Çmimi Neto pa TVSH				
	TVSH (%)				
	Çmimi total me TVSH:				

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës: Shërbimi pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Departamentit të Administratës Publike, për një periudhë 2 vjecare (496 ditë pune).

Shërbimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme duhet të ofrohet duke vënë në dispozicion fuqinë punëtore, mjetet e punës dhe materialet profesionale të pastrimit të Kontraktuesit sipas kërkesave në vijim:

Sipërfaqet e ambienteve të brendshme, të jashtme të godinës pesë katëshe janë si më poshtë:

1. Sipërfaqe sallë mbledhjesh 160 m²;
2. Sipërfaqe të dyshemeve (zyra) 520 m²;
3. Sipërfaqeve të korridoreve dhe shkallëve 360 m²;
4. Sipërfaqe Dritare + Vetrata 1000 m²;
5. Sipërfaqe Tualete 45 m²;
6. Sipërfaqe sheshesh 91 m².

Grafiku i Shërbimeve të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme:

Shërbime me frekuencë ditore:

- Pastrimi, larja e dyshemesë së zyrave, sallave të mbledhjeve, testimeve, korridoreve dhe shkallëve;
- Mbledhja dhe zëvendësimi me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore);
- Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to;
- Pastrimi i moketeve, tapeteve (salla e madhe);
- Pastrimi i dyshemeve me pllaka dhe material parketi të të gjitha ambienteve;
- Pastrimi i WC-ve, aksesorëve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë;
- Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh);
- Pastrimi i dyshemesë me pllaka përpara derës hyrëse (në ambientet e brendshme dhe të jashtme);
- Pastrimi i dyshemesë me pllaka i verandës;
- Largimi i mbeturinave në vendgrumbullimin që ndodhet në hyrjen e derës kryesore të institucionit;

**Zyrat, sallat e mbledhjeve dhe testimeve të pastrohen jo më pak se 1 (një) herë në ditë dhe në raste të vecanta edhe më tepër sipas nevojës. Gjatë 8 orarëshit do bëhet mirëmbajtja e pastrimit të ambienteve e cila do të mbulojë nevojat për pastrim të sipërfaqes së dyshemesë. Me pastrim të zyrave do të kuptohet marrja e pluhurave mbi mobiljet dhe çdo paisjeje tjetër që ndodhet brënda sipërfaqes së zyrës dhe larje të dyshemesë me solucione të lejueshme për përdorim në ambientet e institucionit. Qeset e mbeturinave të zbrazen çdo ditë dhe sipas rastit*

në çdo moment të ditës. Pastrimi në zyra, sallat e provimeve dhe trajnimeve nuk bëhet në orarin pik të punës por në mëngjes dhe me raste edhe në drekë.

*Largimi i mbeturinave nga ambientet te vendgrumbullimin i plehrave bëhet çdo ditë, transporti bëhet me qese/kosha të posaçëm sipas nevojës, të mbyllur me kapakë.

Shërbime me frekuencë periodike:

- Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera;
- Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë;
- Pastrimi i dyerve hyrëse dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.);
- Pastrimi i parmakëve të brendshëm;
- Pastrimi i Magazinave dhe Arkivave;
- Pastrimi i Oborrit (pllakat e betonit në vendin e parkimit);
- Pastrimi i dritareve dhe vetratave brenda dhe jashtë;
- Pastrimi i ambienteve që shërbejnë për Dhomat e Serverave, pastrim dysHEMEJE dhe merimangat;
- Vaditja e luleve në vazo në ambjentet e brendshme.

Tabelë përmbledhëse – Grafiku i kryerjes së shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme.

Nr.	Lloji i Shërbimit	Frekuenca e pastrimit
1	Pastrimi, larja e dyshemesë së zyrave, sallave të mbledhjeve, të testimeve, korridoreve dhe shkallëve	Çdo ditë dhe sipas nevojës
2	Mbledhja dhe zëvendësimi me qese i koshave (për tualet, zyra dhe korridore);	Çdo ditë dhe sipas nevojës
3	Pastrimi i tavolinave, karrigeve dhe pajisjeve informatike mbi to.	Çdo ditë
4	Pastrimi i dollapëve, rafteve dhe mobilieve të tjera.	Dy herë në javë
5	Pastrimi i moketeve, tapeteve (salla e madhe).	Çdo ditë dhe sipas nevojës
6	Pastrimi i dyshemeve me pllaka dhe material parketi të të gjitha ambienteve	Çdo ditë
7	Pastrimi i WC-ve, aksesorëve, dyshemeve, pllakave dhe mureve të tualetit dhe dezinfektimi i tyre brenda dhe jashtë.	Dy herë në ditë
8	Kontrolli dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në WC (letër higjienike, letër dhe likuid duarsh).	Çdo ditë
9	Pastrimi i merimangave nga brenda dhe jashtë.	Një herë në muaj
10	Largimi i mbeturinave në vendgrumbullimin që ndodhet në hyrjen e derës kryesore të institucionit	Çdo ditë
11	Pastrimi i dyerve hyrëse dhe dyert e ambienteve të brendshme (zyra, magazina, arkiva, salla mbledhjeve etj.);	Një herë në javë
12	Pastrimi i parmakëve të brendshëm.	Dy herë në javë
13	Pastrimi i dyshemesë me pllaka përpara derës hyrëse (në ambientet e brendshme dhe të jashtme)	Çdo ditë

14	Pastrimi i dyshemesë me pllaka i verandës	Çdo ditë
15	Pastrimi i Magazinave dhe Arkivave.	Një herë në javë
16	Pastrimi i Oborrit (pllakat e betonit në vendin e parkimit)	Një herë në javë
17	Pastrimi i dritareve dhe vetratave brenda dhe jashtë.	Një herë në muaj
18	Pastrimi i ambienteve që shërbejnë për Dhomat e Serverave, pastrim dysHEMEJE dhe merimangat	Një herë në muaj
19	Vaditja e luleve në vazo në ambjentet e brendshme	Dy herë në javë dhe sipas nevojës

**Përveç Shërbimeve sipas grafikut të mësipërm do të kryhen shërbime pastrimi të tjera, në kushte të jashtëzakonshme në funksion të mirëmbajtjes ditore të ambienteve të brendshme.*

Punonjësit e Shërbimit:

Punonjësit e pastrimit, gjatë kohës së punës duhet të jenë të veshur me uniformën e Kontraktuesit (logo e kompanisë), e cila duhet të jetë gjatë gjithë kohës e pastër dhe e rregullt.

Oraret e kryerjes së shërbimit:

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme do të kryhet nga dita e Hënë në të Enjte, me oraret si më poshtë:

- **06:30 – 15:00 dhe/ose 7:30-16:00**

Dhe, ditën e Premte me orarin e mëposhtëm:

- **06:30-12:30 dhe/ose 7:30-13:30**

Punonjësit në mëngjes duhet të përqendrohen në mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta, duke filluar me pastrimin e tualeteve, korridoreve dhe pastrimin e hyrjeve. Kontrollimi i pastërtisë së tualeteve duhet të bëhet periodikisht. Më pas duhet të bëjnë pastrimin dhe larjen e dysHEMEVE nëpër zyra dhe sallat e mbledhjeve etj, sipas grafikut të kryerjes së shërbimeve.

Materialet e pastrimit:

Për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, nga Kontraktori duhet të vihen në dispozicion materiale shumë cilësore. Ato nuk duhet të jenë gërryes dhe duhet të jenë në të njëjtën kohë pastrues dhe higjienues. Operatori Ekonomik duhet të vejë në dispozicion (**por pa u kufizuar në to**) materiale të tilla si: kosha të vegjël për zyra, korridore, tualete, qese mbeturinash, detergjent për pastrim dysHEMEJE (i cili duhet të jetë sipas llojit përkatës të dyshemesë), detergjent për pastrim parketi, materialet e konsumit (letër higjienike, letër duarsh, sapun likuid), lecka mikrofibër për marrjen e pluhurave, shtupa të posacme për tualete, lecka për fshirje në të thatë, solucion për pastrim pajisjesh informatike, set për larjen e xhamave, karela pastrimi, fshesa e furça pastrimi të ndryshme, fshesa korenti, etj.

Produktet që duhet të vihen në dispozicion duhet të jenë të një cilësie të lartë dhe duhet të kenë specifikimet teknike të pershkuara, si vijon:

1	Solucion larës dyshemeje (pllakash)	litër
2	Solucion për pastrim të parketit	litër
3	Solucion larës xhamash	copë
4	Solucion për larje mobiljesh (me spray) min 500 ml	copë
5	Sapun i lëngshëm	litër
6	Peceta pastrimi mikrofibër	copë
7	Hipoklorit natriumi	litër
8	Shtupa pambuku për larje dyshemeje	copë
9	Peceta pluhurash të thjeshta	copë
10	Qese mbeturinash të vogla	pako
11	Qese mbeturinash të mëdha	pako
12	Kova plastike me shtrydhje	copë
13	Letra higjenike e paketuar	Rulon/ pako
14	Letra duarsh	copë
15	Kosha plastik i madh	copë
16	Kosha tualeti me pedale	copë
17	Kosha plastike për hedhjen e mbeturinave	copë
18	Mbajtëse letra për duar	copë
19	Mbajtëse për letra higjenike	copë
20	Furça për pastrimin e wC	copë
21	Letër guzhine e paketuar	Rulon/ pako
22	Solucion larës wC dezinfektues	litër
23	Acid për pastrim	litër

1. Solucion larës dyshemeje (pllakash). Me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

2. Solucion për pastrim të parketit. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale (jo më shumë se 5.5%.

3. Solucion larës xhamash. Me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³. Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.

4. Solucion per larje mobiljesh (me spray) min 500 ml. Të ketë aromë të lehtë. Të jetë linjë profesionale.

5. Sapun i lëngshëm. Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm³. Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11 %. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës..

6. Peceta pastrimi mikrofibër. Të jetë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobilieve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë në ambalazhim min 3 cope/pako.

7. Hipoklorit Natriumi per larje dyshemeje, Përmbajtja e klorit aktiv te jete 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo me shume se 5%, të mos ketë përmbajtje të lendeve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të celët, me erën karakteristike shpuese në hunde. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik. Ambalazhimi te jetë i etiketuar. Të jetë cilësor.

8. Shtupë pambuku për larje dyshemeje. Përbëhet nga fibra tekstili me përbërje mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

9. Peceta pluhurash të thjeshta, Të jenë të paketuara në qese min 3 fije /pako. Të jenë me shumë se një përdorimeshe. Të kenë veti të mira përthithëse.

10. Qese mbeturinash te vogla. Të jenë rezistente, të kenë përmasa të ndryshme min 30x50cm (+/- 5cm) dhe min 10 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi, të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

11. Qese mbeturinash (te medha). Të jenë rezistente, të kenë përmasa të ndryshme min 70x100cm (+/- 10 cm) dhe min 10 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

12. Kova plastike me shtrydhje. Të jetë plastike, me kapacitet min 10 Litër, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jete me volum min 10 Litër.

13. Letër higjenike e pakeluar. Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, me fletë palosje zig zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.

14. Leter duarsh. Me kuti, fletë palosje zig zag me përberje 100% celuloze. Të jetë e pakeluar në kuti ose në qese min 250 fije/pako. Letra të ketë mundësi thithje të lartë.

15. Kosh plastik i madh. Të jetë në forma te ndryshme, me kapak nga sipër që hapet plotësisht. Të ketë dy doreza në pjesën anësore me qëllim transportimin e tij. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum minimal 50 Litër.

16. Kosha tualeti me pedale. Kapaciteti të jete me volum min 3 Litër. Materiali metalik me qëndrueshmëri të lartë, rezistent ndaj ndryshkjes. Hapja dhe mbyllja e tij të realizohet me anë të pedales.

17. Kosha plastik për hedhjen e mbeturinave, të jetë në formë drejtkëndore ose rrethore, me kapak nga sipër qe hapet si dritare. Kapaciteti mbajtës i koshit te jetë me volum min 5 Litër.

18. Mbajtëse letre per duar. Makineta të instalohet shumë lehtë në sipërfaqe si pllaka, material plastik rezistente. Nxjerrja e letrës të bëhet nga poshtë aparatit.

19. Mbajtëse për letra higjienike. Të jetë cilësore me material rezistent për mbajtësen e letrës.

20. Furça për pastrimin e WC. Të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.

21. Letër guzhine e paketuar. Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, me fletë palosje zig zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.

22. Solucion larës WC dezinfektues. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.

23. Acid për pastrim. Të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 03. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

Furnizimi me materiale pastrimi duhet të bëhet sipas një itinerari të caktuar apo sipas nevojave dhe konsumimit, nën kujdesin e Supervizorit të Kontrakuesit i cili duhet të bëjë shpërndarjen e tyre dhe të sigurojë që mos të mungojë asnjëherë furnizimi.

Tualete e brendshme të godinës pesë katëshe janë si më poshtë:

- Tualete 8.

Kontraktuesi duhet të bëjë furnizimin me materiale e detergjentë pastrimi dhe mirëmbajtje duke pasur parasysh ambientet e mësipërme.

Pastrimi i dyshemesë: Duke qenë se dyshemetë janë me përbërje të ndryshme, edhe mënyra e pastrimit të tyre duhet të bëhet në varësi të llojit, në mënyrën dhe produktet e përshtatshme.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen :

Shërbimi pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Departamentit të Administratës Publike, për një periudhë 2 vjecare (496 ditë pune).

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimi	Përshkrimi	Njësia	Sasia në M2	Frekuenca/ditë	Frekuenca/muaj	Volumi ditor	Volumi mujor	Volumi total
Sipërfaqe dysheme + Korridore + Shkallë	Sipas specifikimeve teknike	m2	1040	1		1040		515,840
Sipërfaqe Tuate	Sipas specifikimeve teknike	m2	45	2		90		44,640
Sipërfaqe Ambjent i Jashtëm	Sipas specifikimeve teknike	m2	91	1		91		45,136
Sipërfaqe Dritare+Vetrata	Sipas specifikimeve teknike	m2	1000		1		1000	24,000

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe frekuencave të përcaktuara në specifikimet teknike, brenda vlefshmërisë së Marrëveshjes Kuadër.

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbim pastrimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme për Departamentin e Administratës Publike

Detyrat: Kryerja e shërbimit të pastrimit, me korrektësi dhe konform specifikimeve të kërkuara.

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Departamentit të Administratës Publike

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënues për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënues ose nuk ka qenë i dënues nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021-2022-2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të pastrimit të ambienteve të jashtme e të brendshme, objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës, si më poshtë:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1	Përgjegjës Shërbimi	1 (një)
2	Punonjës pastrimi/sanitar	2 (dy)
	Totali	3 (tre)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

a) Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi/Ekspert Mjedisi, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi dhe/ose Certifikatë “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor”;
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b) Për punonjësit e pastrimit/ sanitar, të paraqitet:

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojnë se do të sigurojnë furnizimin, me shpenzimet e veta dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara, të pajisjeve, materialeve dhe aksesorëve të pastrimit, të cilat nevojiten për përmbushjen e kontratës/ava që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimënësë vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
